

Emine SHABANI
TRAGJEDIA GRATË TROJANE NGA SENEKA, NJË KËNDVËSHTRIM
I PËRGJITHSHËM

Abstrakt: Sikur të mos i kishte recituar vargjet epike të Luftës së Trojës, Homeri, sot nuk do të kishim as dhe këto vepra dhe mijëra të tjera intertekstuale e intermediale. Letërsia, por edhe historia e shkencat e tjera ruhen kur shkruhen! Ngjarje shumë e rëndësishme dhe tronditëse, për kohën kur u zhvillua, së cilës nuk i është zbehur lavdia edhe sot, madje mund të thuhet se është rikthyer më i fuqishëm debati për të kohëve të fundit, falë zhvillimeve teknologjike, që zbulojnë artefakte të reja që kanë të bëjnë me këtë periudhë dhe ngjarjet e implikuara, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Punimi synon zbërthimin e disa elementeve që lidhen fuqishëm me të kaluarën e shqiptarëve dhe popujve tjerë të ish gadishullit Ilirik, fiseve ilire, pellazge, e të tjerëve që jetonin në Azinë e Vogël. "Gërmimi" nën sipërfaqen e historisë nxjerr në pah shumë elemente interesante dhe me vlerë që me ndihmën e teknologjisë qoftë asaj digjitale (bibliotekave), ose eksploruese në sitet arkeologjike dhe krahasimet e simboleve fetare, totemike, kulturore e shkencore që kanë ekzistuar në lashtësi dhe vazhdimësi e tyre që arrin deri në kohët tona.

Fjalët kyçe: Lufta e Trojës, tragjedia e përgjithshme, ajo familjare dhe individuale, fati i grave trojane, Hekuba, Andromaka, Astynaksi, Poliksena, Kasandra, etj.

Poetika e pikëllimit te Gratë trojane të Senekës dhe Euripidit

Një temë e vjetër mbi tre mijë vjeçare që nuk shteret edhe sot e në vazhdim. Misteri i kësaj lufte, akoma është çështje debati dhe kontesti mes historianëve të ndryshëm, ata janë të ndarë, në ata që besojnë vërtetësinë e kësaj lufte dhe skeptikët që nuk besojnë se kjo luftë ka ndodhur. Si do qoftë, një dëshmi të kësaj lufte na ka lënë Homeri, në veprat epike Iliada dhe Odiseja, Dikti i Kretës, si pjesëmarrës i kësaj lufte, Quintus Smirnaeus-i, Tryphiodorus-i, Apollodori, Dares i Frigjisë, Apiani, Straboni, etj, këta të fundit historianë, që me faktet e tyre e dëshmojnë vërtetësinë e kësaj lufte gjithmonë aktuale!

Pse ndërron disponimi i Athënës pas rënies së Trojës dhe çfarë kuptimi ka dialogu mes Poseidonit dhe asaj tek Euripidi ndërsa te Seneka mungojnë personazhet e perëndive dhe perëndeshave?

Elementet e karakterizimit dhe narracionit te konceptimi i figurave të perëndive dhe perëndeshave që i hasim tek Euripidi dhe mungesa e tyre te Seneka përfaqësojnë alegorinë dhe bërthamën mitike që mbështjell me mjeshtëri të vërtetën e këtyre rrëfimeve. Integrimi i mitit është pika enigmatike, kyçe, në tekst janë vende ku strehohen dhe lidhen pikat kryesore, prapavija dhe fshihet e vërteta e veprës. Figurat komplekse të perëndive dhe intervenimet e

implikimet e tyre në jetën e njerëzve, si rezultat i besimeve të dy taborëve në të njëjtat perëndi! Sepse të dy popujt e përfshirë në këtë luftë, sipas të dhënave historike e argumenteve të historianëve, gjeografëve e shkrimtarëve antikë janë të të njëjtit etnitet pra kjo luftë ishte Pellazge-Ilire.

Sipas legjendës tre perëndeshat Athëna, Afërdita dhe Hera, ^{xi} ishin zënë mes vete se kush ishte më e bukura dhe për ta zgjidhur këtë enigmë ata thirrën Parisin, princin trojan që tu tregojë duke e hedhur mollën e artë tek ajo që ai do ta përcaktonte si më të bukurën! Ndërkohë Afërdita e kishte korruptuar atë duke i thënë nis, do ta zgjidhte atë, si shpërblim do t'i jepte gruan më të bukur në botë, Helenën e Spartës. Pariu (Parisi) i tunduar nga ky shpërblim i madh ja hodhi mollën Afërditës. Ky gjest e zemëroi shumë Athënën dhe ajo vendosi të hakmerret. Ajo ndihmoi akejtë ta fitonin luftën kundër trojanëve, por siç e shohim te dialogu hyrës te Euripidi mes saj dhe Poseidonit, Athëna është e indinjuar dhe zemëruar për dhunimin dhe prishjen e tempujve, dhunimin e Kasandrës nga Aia në tempullin e Apollonit:

ATHENA

Dost not know the insult done to me and to
the shrine I love?

POSEIDON

Surely, in the hour that Aias tore Cassandra
thence.

(Euripides:3)^{xi}

Çfarë i përfshiu në këtë luftë këta dy fise të një etniteti? Nga njëra anë ashtu siç mund të pritet në një kohë antike shek. XXI p. K. është çështje përmbushjes së një profecie, e parathënë, e parashikuar, nga ana tjetër është një konflikt i vjetër që recidivonte dhe nuk arriti të mbyllet me paqe, ose çështje shkeljes së nderit sipas Kanunit antik, hakmarrje, xheloz, lakmi, etj.

E para profeci që u përmbush ishte ëndrra e Hekubës, që kur ishte shtatzënë, pa se nga barku i saj doli një flakë që dogji Trojën, nga frika ajo u zgjua dhe i tregoi të shoqit Priamit, ëndrrën dhe ata u morën vesh që këtë fëmijë ta largojnë nga pallati, sepse paralajmërimi ishte i kobshëm.

Konflikti i vjetër mes trojanëve dhe akejve ishte rrëmbimi i princeshës trojane nga akeasit, motrës së Priamit, Hesionës. Për këtë rrëmbim u bë një debat disa vjeçar por nuk u arrit marrëveshje dhe kjo çoi deri në rrëmbimin e Helenës së Spartës si shenjë hakmarrjeje. Nga këto ngjarje shohim se këta popuj antik, kanë pasur kanune që i kanë respektuar dhe, respektimi i tyre është ngritur deri në shenjtëri. Seneka (viti 4, para K.-v.65 pas K.), ky autor i njohur antik filozof e shkrimtar tragjedian, përveç Fedrës, Edipit, Medeas, Thyestit, shkruan edhe tragjedinë Gratë trojane i ndikuar nga Euripidi (v. 485-406, para K.) por për dallim nga ky i fundit, Seneka në këtë tragjedi nuk ka personazhe perëndi, që ndihmojnë njërin palë dhe janë kundër palës tjetër në konflikt, ashtu siç ndodh tek Euripidi. Titulli i veprës shpesh lexohet si përkufizues i

fatit, i zgjidhjes së rrugës dhe, ky titull e tregon atë, sepse autori nuk vendosi një titull për burrat trojanë, ata luftuan dhe sakrifikuan jetën e tyre në mbrojtje të Trojës dhe familjeve të tyre, ndaj ky titull është intrigues: Gratë trojane, sepse ajo që mbeti pas timit dhe flakës së këtij qyteti të lavdishëm, janë Gratë trojane ato që do t'i vajtojnë më të dashurit e tyre të vdekur mbi rrënojat e Trojës. Dhe këto vajtime kanë rituale çuditërisht të ngjashme me ritualet që vijnë deri sot e kësaj dite në vajet shqiptare, të krahinave të ndryshme, por këto rituale kanë qenë të pranishme edhe te popujt tjerë evropianë si: keltët, gjermanët, latinët, spanjollët etj.

Cilat janë ngjashmëritë mes vajeve të grave trojane dhe fiseve shqiptare që i ruajnë këto rituale dhe sot akoma ?

Në shumë krahina të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, kemi reminishenca të këtyre vajeve si te gratë ashtu edhe te burrat. Këto rituale në disa vende janë të zbehura, si pasojë e konvertime fetare që kanë ndodhur për shekuj me radhë. Si në krishterizëm , ashtu edhe në islamizëm të vajtuarit me ligje, e të vdekurve ka qenë e ndaluar, kjo gjë u ndalua rreptësisht në Shqipëri sidomos pas viteve të 60-ta. Por këto elemente janë të pranishme në gurë, libra, kujtesën popullore të bartur brez pas brezi. Ato i gjejmë te vepra e Frang Bardhit (1641) që me hollësi e përshkruan gjamën e burrave dhe vajtimin e grave: “Të gjithë shkyhen rrobash, burrat gërvishtin fytyrën deri sa të shpërthejë rrjedhë gjaku dhe, presin mjekrën e nuk rruhen në shenjë trishtimi të madh dhe, gratë shkurtojnë flokët e rrahin gjokset, kështu që disa herë me vështirësi, lejojnë të bëhem funksionet nga britmat e përplotshme” (Tirta: 2004:221)

Këtë lloj rituali e praktikoi Akili, kur u vra shoku i tij i ngushtë Patrokli dhe, ky moment ishte kthesa e fuqishme e rikthimit të tij në fushëbetejë, akoma më i egër, që atëherë është shndërruar në arketipin e zemërimit të Akilit.

Ritualet e vajtimin në trojet shqiptare i kanë ruajtur ato reminishenca pagane në bërthamën e tyre, deri vonë nga shekujt mesjetës, siç është vajtimi i Skënderbeut nga Lekë Dukagjini dhe princërit tjerë, gjeneralët dhe ushtarët e Skënderbeut, me anë të ritualeve çjerrjes së fytyrës, vajtimin shpërthejnë në britma përnjëherësh, duke vënë një dorë te goja dhe tjetrën te veshi, duke thirrur emrin e të ndjerit, ose duke e thirrur, “Hej mor vëlla” nqs, është i gjakut e fisit. Pastaj vazhdojnë me grushta duke e goditur kraharorin... Ndërsa në fazën e dytë të gjithë burrat mbanë kokën lartë dhe janë krahërorzbuluar, ky element përshkruhet edhe tek Euripidi dhe Seneka, por këtu është fjala te vajtimi i grave trojane, që vajin e nis Hekuba dhe të tjerat e ndjekin njëzëri:

I trust you, friends who shared my
downfall.

Let your hair fall free.
Let it flow sadly down your backs
dirty with the tepid dust of Troy.

Fill your hands:

this at least we can take away from
our city.

All of you, stretch out your arms,
and be prepared: let down your
dresses, hitch up the fabric, let your
bodies be naked to the belly.

What wedding can you wait for, that
you bother to cover your breasts,
such self-respecting slaves?

(Seneca, f. 144, paragraph 90)^{xi}

Ajo u thotë të mbushin grushtet me dheun e Trojës dhe hirin e nxehtë të qytetit të djegur, si e vetmja gjë që mund ta marrin me vete, pasi ishin caktuar skllave tek akejtë.

Rituale të njëjta praktikon edhe Aleksandri i Madh kur i vdes shoku i tij më besnik, rituale që edhe për kohën e tij quheshin të lashta.

Kur po ndërtonte flotën për të pushtuar tokat deri në Gjibraltari, Aleksandri i Madh, sëmuret rëndë dhe vdes shoku i tij Hefesti, që e kishte si vëlla. Hidhërimi e tërboi. Nuk kishte njeri ta ngushëllonte për vdekjen. E humbi arsyen dhe qau, tre ditë mbi kufomën e tij, shkuli flokët dhe i qethi, preu jelet e kuajve dhe dha urdhër që të mbante zi gjithë Perandoria. (Kocaqi, 2012:99)

Një element tjetër me rëndësi për ta përmendur është edhe vdekja e gruas së Darit, gjatë kohës që qëndronte në kampin e Aleksandrit: *“Ajo sëmuret rëndë dhe vdes. Aleksandri u prek shumë sikur ta kishte nënë. Qau, mbajti zi dhe agjëroi për të. I bëri varrimin si mbretëreshë”*. (Kocaqi:2012:99) Të njëjtin vajtim-lament e bëri edhe Gilgameshi sumerian, kur i vdiq shoku i tij Enkidiu, shtatë ditë vajtoi mbi varrin e tij dhe u largua përgjithmonë nga Uruk.

Në Maqedoninë e Veriut, më së shumti në trevën e Kërçovës, të Dibrës dhe në raste të veçanta në disa fshatra të malësisë së Tetovës (me përjashtime, kur i vdekuri ka qenë djalë i ri apo vajzë e re, nuk është ndaluar vajtimi me ligje, pasi që ka qenë spontan dhe ka ardhur natyrshëm nga dhimbja e personave të afërm). Këto rituale mortore, janë ruajtur me fanatizëm deri në ditët tona, të transformuara dhe të shoqëruara nga elemente të reja duke ruajtur reminishenca të zbehta nga lashtësia të gërshetuara edhe me elemente fetare.

Tragjeditë Gratë trojane të Senekës dhe Euripidit, janë rezultat i epilogut të luftës së Trojës. Hapja e skenës është pamja e mjerë e Hekubës pas vrasjes së Hektorit, Priamit, princërve trojanë, popullit të masakruar, fëmijëve të vrarë dhe grave të dhunuara!

Where are your tears? Are they stopping?
My people, all you slave-women,
beat your breasts with your hands, give
shrieks and wails, a funeral for Troy. At
last, let Ida ring
with tears, that place of death, home of that
terrible judge. chorus You tell us to weep.
We know well how to do it.
We have been practising.
We have been in mourning for years,
ever since our Phrygian prince visited
Spartan Amyclae, and the pine tree
holy to Cybele, cut through the ocean.
(Seneca: 144, paragraph 70)^{xi}

Transplantimi antik i vajeve për të cilin i thërret Hekuba gratë trojane të vajtojnë si në lashtësi!

Kjo dtth, se këto vaje, kjo mënyrë e lamentit të të vdekurve kishte qenë në traditën e trojanëve shumë më herët me rituale të cilat kanë mbijetuar deri sot dhe të cilat janë autentike ndër shqiptarët pothuajse në të gjitha trojet. Ata sot janë sinkretizuar me elemente monoteiste, por thelbi i lamentit antik ka mbetur i njëjtë: vajtimet me ligje, madje edhe namatisje, nëmet natyra, jeta deri në asgjësim, kur vdes një i ri ose e re në ato familje.

Now I recognize a Trojan company.
Now let the old laments return
again.
Outdo the way we used to weep.
We weep for Hector.
(Seneca, f. 144, paragraph 100)^{xi}

Ndërsa Hekuba vajton Hektorin dhe Priamin, akejtë japin urdhër të gjejnë Astinaksin dhe ta vrasin, e në anën tjetër Pirroja, djali i Akilit, kërkon Poliksenën ta bëjë kurban mbi varrin e të atit. Një nga skenat më tronditëse dhe madhështore në këtë akt tragjik, është qëndrimi i guximshëm përballë vdekjes i Poliksenës, që habit edhe trimat më të krisur akej që luftuan për ta rrënuar Trojën. E bukur, shtatlartë, flokartë, qafëgjatë, sykaltër, e zgjuar dhe e përzemërt, me bukuri dhe trimëri ajo ua kalonte gjithë të tjerave, kështu e përshkruan Dari i Frigjisë Poliksenën që e bënë kurban te varri i Akilit, ose martesë sakrale, me gjakun e saj. Gjatë kryerjes së këtij riti

edhe Pirro është i ngadalshëm, ndjen keqardhje? Por nuk guxon t'i dridhen duart, duhet ta çojë amanetin në vend, hakmarrje ndaj Parisit, kundërvlerë e jetës së Akilit, vdekja e Poliksenës. Ajo bukuri sa për tu admiruar, shkon pa frikë drejt vdekjes, me lëkurë më të bardhë, me shikim të guximshëm, *fytyra e saj e shkëlqente ëmbël si dielli pak para se të perëndojë, që ditën e dyshimtë e shtyp nata pasuese*, kështu e përshkruan Seneka qëndrimin e Poliksenës, çastin e fundit të jetës së saj. Turma e trojanëve dhe akejve që po shikonin këtë skenë të habitur kush nga bukuria e saj, kush nga dhimbja për rininë e saj, është pafundësisht tërheqëse, ajo fytyrë e brishtë që do të tretet, që i është kushtuar vdekjes! Skenat e të dy tragjediave përmbillen me thirrjet e ushtarëve akej, që gratë trojane të nisen drejt bregut, drejt skllavërisë që i priste...

Bibliografia

- Kocaqi, E. (2012), *Albanët, shqiptarët me famë botërore*, Emal, Tiranë.
- Seneca, (2010), *Six Tragedies*, Oxford World Classic's Translated with an Introduction and Notes by EMILY WILSON, Oxford University Press.
- Euripides, Michael J. Anderson, *The Fall of Troy in Early Greek Poetry and Art*. Oxford: Clarendon Press, 1997. ISBN 0-19-815064-4.
- Jung, Carl Gustav, (2010), *Ese mbi gjurmimin e të pavetëdijshmes*, Fan Noli, Tiranë.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, (2015) *Shtëpia botuese Kuvendi*, Shkodër.
- Bekos, Janis (1991), *Euripidi në prozë*, Naim Frashëri, Tiranë.
- Frojd, Zigmund (2010), *Mbi letërsinë dhe artet*, Fan Noli, Tiranë.
- Aristoteli, (1998), *Poetika*, Rilindja, Prishtinë.
- Cermanovic, A. Srejovic, D. (1992), *Leksikon religjia i mitova drevne Evrope*, NOLIT, Beograd.
- Gerald, P. *Dictionary of Narratology*, (2010), Nebraska University Press.
- Kodra, Z. Et al. (1996), *Folklor Shqiptar Proza Popullore I*, Tiranë.
- Lotman, J. (2005), *Strukturata na umetnickoite tekst*. Detska Radost, Shkup.
- Tresider, J. (2001), *Речник на симболи*, Детска Радост, Скопје.
- Harl, Kenneth, (1971), *Great Ancient Civilisation of Asia Minor*, Berkeley: University of California Press.
- Peterson, B. Jordan, (1999), *Maps of Meaning*, ROUTLEDGE, New York and London.
- Eberhard Zangger (2016): *The Luwian Civilization: The Missing Link in the Aegean Bronze Age*. Ege Yayınları, Istanbul. 292 pages, 148 color illustrations. ISBN 978-605-9680-11-0
- Menninger, Karl, *Man Against Himself*, (1985), San Diego : Harcourt Brace Jovanovich.
- Tirta, M (2004), *Mitologjia ndër shqiptarë*, Mësonjëtorja, Tiranë.